



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr.350/5 Prot

Tiranë, më 17.03.2023

VENDIM

Nr.09, datë 17.03.2023

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 350 Prot., datë 14.02.2023, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik “Bashkia Mallakastër” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e kërkuarit, nëpërmjet kërkesës datë 01.02.2023, depozituar në adresat elektronike Ballshi@bashkiamallakaster.gov.al; Info@bashkiamallakater.gov.al, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, në lidhje me:

1. *Një kopje të projektit të miratuar të rikonstruksionit të rrugës/rrugëve të fshatit Dukas, Komuna Qendër, Mallakastër;*
2. *Vendosjen në dispozicion të çdo dokumenti praktike dokumentare në lidhje me rikonstruksionin e rrugës të fshatit Dukas, Komuna Qendër, Mallakastër, duke përfshirë por pa u kufizuar si: Vendim i Këshillit Bashkiak, shoqëria zbatuese e projektit, financimi i projektit, harta e rrugës, pronat privat që cenohen apo shpronësohen, akti i shpronësimit;*
3. *Nëse ka ndryshim projekti sa i përket devijimit të rrugës, lutem të më vendoset në dispozicion çdo akt që akt vendimmarrës që ka ndryshuar projektin;*
4. *Çdo dokument tjetër në lidhje me zbatimin e projektit.*

Ankuesi, pas përgjigjes së Autoritetit Publik nëpërmjet e-mail-it datë 13.02.2023, me pretendimin se informacioni i vënë në dispozicion nuk është i plotë, i është drejtuar Zyrës së Komisionerit, duke kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e dhënies së informacionit/dokumentacionit të kërkuar nga Autoriteti Publik.

Zyra e Komisionerit pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”*, Komisioneri, me shkresën nr. 350/1 prot., datë 15.02.2023, ka kërkuar nga Autoriteti Publik të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për informacion, brenda datës 22.02.2023.

Autoriteti Publik, nëpërmjet shkresës nr. 749/1 Prot., datë 21.02.2023, ka kthyer përgjigje duke bërë me dije ndër të tjera se: *“...Bashkia Mallakastër në zbatim të përcaktimeve ligjore të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, nëpërmjet përgjigjes datë 13.02.2023 i ka dërguar informacionin/dokumentacionin respektiv kërkesit. I gjithë informacioni i është vënë në dispozicion sipas kërkesës”*.

Pas përgjigjes së Autoritetit Publik, ankuesi, me e-mail-in datë 22.02.2023, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 350/2 Prot., datë 22.02.2023, ka vijuar ankimin për pikat 1, 2 dhe 4 të kërkesës për informacion.

Në vijim, Zyra e Komisionerit me e-mail-in datë 27.02.2023, ka kërkuar nga Autoriteti Publik qëndrimin përfundimtar mbi disponimin e informacionit të kërkuar.

Ankuesi, pas përgjigjes së Autoritetit Publik të datës 01.03.2023, nëpërmjet e-mail-it datë 03.03.2023, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 350/4 Prot., datë 03.03.2023, ka saktësuar mbi informacionin që Autoriteti Publik nuk ka vendosur në dispozicion sipas pikave 1, 2 dhe 4 të kërkesës për informacion, si dhe duke kërkuar në vijim nga Zyra e Komisionerit detyrimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i Autoritetit Publik nuk është në përputhje me dispozitat e LDI, si dhe detyrimet që burojnë nga ky i fundit.

Bazuar në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 2 të LDI parashikohet se: *“Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet*

e njësisve të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj”.

Në kuptim të këtij parashikimi, Bashkia Mallakastër është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në pikën 1 të nenit 1 përcakton se: *“1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike”.* Në këtë kuptim, çdo autoritet publik pavarësisht nëse është në cilësinë e *“prodhuesit”* apo *“mbajtësit”* të informacionit, detyrohet të garantojë njohjen e publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit dhe të shoqërisë.

Nga shqyrtimi i çështjes, konstatohet se objekti i kërkesës për informacion/dokumentacion lidhet me investimet e Autoritetit Publik në punët publike, si dhe procedurën e ndjekur për realizimit e tyre, konkretisht, mbi rikontruksionin e rrugës së fshatit Dukas, Komuna Qendër, Mallakastër.

Për sa më sipër, informacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të LDI, sipas të cilit *“informacion publik”* konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”. Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar.

LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti që ushtron funksione publike.

Bazuar në pikën 7, fusha 2, të Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore miratuar me Urdhrin nr. 211, datë 10.9.2018 të Komisionerit, *“Transparenca dhe Llogaridhënia Ekonomiko-Financiare”, në pikën 7, Monitorimi dhe mbikëqyrje e buxhetit: 3. Informacionit për zbatimin dhe monitorimin e kontratave (punëve publike, mallrave, shërbimeve)”,* një pjesë e informacionit të kërkuar përfshihet në kategorinë e informacionit, që vendoset në dispozicion të publikut pa kërkesë.

Gjithashtu, detyrimi për bërjen transparente të veprimtarisë së tyre, njësisve të qeverisjes vendore i`u lind gjithashtu edhe në zbatim të Kreut VI, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Konkretisht në nenin 15 të ligjit të sipërcituar “Transparenca e veprimtarisë së njësisve të vetëqeverisjes vendore”, parashikohet se: *“1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre. 2. Çdo akt i organeve të vetëqeverisjes vendore publikohet në faqen zyrtare të internetit të njësisë vendore dhe afishohet në vendet e caktuara nga njësia për njoftimet publike...”.*

Në pikën 3 të nenit 3 të ligjit të LDI parashikohet se: “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin pjesërisht të ankesës nr. 350 Prot., datë 14.02.2023, nga z. _____, kundër Autoritetit Publik, “Bashkia Mallakastër”, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar sipas kërkesës për informacion të datës 01.02.2023, konkretisht për pikat: (- 1. *Një kopje të projektit të miratuar të rikonstruksionit të rrugës/rrugëve të fshatit Dukas, Komuna Qendër, Mallakastër*; - 2. *Vendosjen në dispozicion të çdo dokumenti praktike dokumentare në lidhje me rikonstruksionin e rrugës të fshatit Dukas, Komuna Qendër, Mallakastër, duke përfshirë por pa u kufizuar si: Vendim i Këshillit Bashkiak, shoqëria zbatuese e projektit, financimi i projektit, harta e rrugës, pronat privat që cenohen apo shpronësohen, akti i shpronësimit*; - 4) *Çdo dokument tjetër në lidhje me zbatimin e projektit*), brenda datës 27.03.2023.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja djeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 17.03.2023.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi